

RAPORT

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

REFERUAR LIGJIT NR: 10440, SHTOJCA 2. PIKA 3/B



**ZHVILLIMI I RRJETIT
TM 20Kv FIDERI F-3,F-4
NENSTACIONI 110/20kV
GJIROKASTER.**

OSHEE sh.a.
Drejtoria Rajonale Gjirokaster
DHJETOR 2015

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Lënda	Faqe
I Hyrje	3
II Vendodhja	4
III Gjendja e mjedisit	7
a. Kushtet klimatike	7
b. Hidrologjia	8
c. Sizmiciteti	8
d. Biodiversiteti, flora, fauna	9
IV. Karakteristikat e projektit	12
V. Organizimi i punës	48
VI. Ndikimi në mjedis	48
a. Mbetjet e ngurta	48
b. Shkarkimet ne ujrat sipërfaqesore e nëntoksore	49
c. Ndikimet ne ajër	49
d. Zhurmat	49
dh. Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu	50
e. Ndikimet ne tokë, në klime, në florën, faunën dhe gjeologjinë.	50
ë. Ndikimi ne infrastrukturen urbane te zonës.	50
f. Perputhshmeria me planin urbanistike rregullues te zonës.	51
g. Ndikimi në trashëgimin kulturore	51
VIII. Masat per mbrojtjen e mjedisit	52
a. Mbetjet e ngurta	53
b. Ujrat e përdorura	53
c. Ndikimi në ajër	53
d. Zhurmat	54
dh. Shfrytezimi i burimeve natyrore	55
e. Kerkesat teknike, estetike e ekologjike	55
ë. Parandalimi i rreziqeve	56
IX. Monitorimi i mjedisit	58
X. Konkluzione	58

I. HYRJE.

Në mënyrë të veçantë zhvillimet e zonave urbane e veçanërisht ato turistike kërkojnë veç të tjerave dhe plotesimin e kërkesave për furnizim me energji elektrike sipas standarteve bashkekohore. Projekti "Zhvillimi i rrjetit TM 20 kv fideri F3, Nenstacioni 110/20kv Gjirokaster" i OSHEE-se ka të bëjë në mënyrë specifike me permirsimin e furnizimit me energji elektrike me rrjet 20kv pjeses së mbetur të qytetit të Gjirokastrës dhe për këtë qëllim do të shtrihen dy fidera të rinj 20Kv nga N/Stacioni Gjirokastra e Re 110 /20 Kv Gjirokaster.

Bazuar në ligjin me nr. 10440, datë 7.7. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, ky projekt i **i nënshtrohet procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas shtojcës II të këtij ligji, pika 3, shkronja "b**, Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrorhtë; **transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartësi** (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I)". Mbeshtetur në këtë ligj, ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është dokumenti bazë ku mbështetet procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Gjithashtu, pergatitja e këtij raporti është në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 2.12.2013 për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore të tipit A, B dhe C për aktivitete të reja dhe ekzistuese, pika "2.2" Dokumentacioni teknik (përshkrimi i aktivitetit, skica, harta etj.), që përbëhen nga: (pika "c") Raportin e përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të hartuar nga ekspertë të çertifikuar e të përzgjedhur nga kërkuesi i lejes mjedisore.

Ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka si qëllim:

- Identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative në mjedis si rezultat i zbatimit të projektit të propozuar;
- Evidentimin e sigurimin e masave që zbusin ose kompensojnë ndikimet negative në mjedis si rezultat i zbatimit të këtij projekti.
- Monitorimin e procesit të zbatimit të projektit për të garantuar respektimin e e ketyre masave.

Zbatimi i këtij projekti ka të bejë më ristrukturimin sipas standarteve më të avancuara të rrjetit shpërndarës elektrik në pjesën e mbetur të qytetit të Gjirokastrës, zhvillim i cili duhet të përputhet me kriteret mjedisore të kësaj fushe, për eliminimin ose minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

II.VENDNDODHJA.

Qyteti i Gjirokastrës, vendi ku zbatohet projekti është qytet në Shqipërinë jugore, shtrihet në shpatin e Malit të Gjerë, nga faqja e këtij mali zbret deri në buzën e lumit Drino. Qyteti është mbisundues dhe me një pejsazh të pasur në anën lindore të një lugine shumë të bukur i vendosur në shpatet e pjerrëta të saj, kufijtë e të cilit përvijohen nga maja maresh të larta. Ky është “qyteti i një mijë shkallëve” që përfshin qindra shtëpi-kullë të tipit otoman me çatitë dalluese të gurta, ballkonet e drunjta dhe muret e gurta herë-herë të zbardhura me gëlqere. Qyteti me kalanë (bërthama e parë e vendbanimit) dhe lagjet e tipit osman, ndërtuar mbi kreshta, që vijnë duke u larguar nga kalaja deri në tabanin e luginës, ku ndodhen ndërtimet bashkëkohore dhe kompleksi universitar. Lagjet tradicionale shtrihen në formë rrezesh rreth kalasë. Kalaja madheshtore që ngrihet mbi një kodër të thiktë mbisundon kete qytet.

Qytet i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit otoman.

Gjirokastra është një nga qytetet më të bukura të Shqipërisë për vlerat e saj arqitektonike dhe historike. Qyteti dominohet nga një kështjelle e mrekullueshme, dëshmitare e kohrave të ndryshme.

Qyteti me popullsi 40 000 banorë, është qendra ekonomike e administrative e rrethit me të njëjtin emër.

Si shumë qytete në Shqipëri, pas rënies së komunizmit ka rritje të shpejt të popullsisë urbane. Veçanërisht në dy dekadat e fundit, qyteti i Gjirokastrës ka njohur zhvillime të vrullshme nga ana urbane në mënyrë të veçantë me ndertime rezidenciale, hoteleri e bare, duke spikatur si vend turistik mjaft tërheqës. Keto zhvillime kanë ndikuar gjithashtu në një presion në rritje ndaj mjedisit natyror.

Ky qytet ndodhet 236 km (ne rruge tokesore) me Tiranen ose 197 km nga Porti i Durrësit. Gjirokastra si rreth 56,000 banorë, një sipërfaqe prej 1,137 km².

Ne Luginën e Drinos gjenden disa site arkeologjike ku me te rëndësishmit janë "Antigonea", rreth 14 km nga Gjirokastra dhe siti romak i Hadrianopolit shek.II ps.k. ne afërsi te fshatit Sofratike. Mbresëlënëse dhe me vlera historike e arkitektonike janë edhe Kishat paleokristiane te Shën Marise Labove dhe Peshkepi.

Gjirokastra (qe perfshin Tepelenen dhe Memalian) është një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike në Jugun e Shqipërisë. Pika e Doganore e Kakavijes, është pika kufitare me fluksin më të madh udhëtarësh dhe mallrash për në Greqi




Fig. 1 Shtirja e qytetit te Gjirokastrës dhe pozicioni gjeografik i vendit ku zbatohet projekti (Fideri 3, me ngjyre te kuqe).



Fig. 2 Pozicioni gjeografik i vendit ku zbatohet projekti, (fragment qyteti, Fideri 3, ngjyre e verdhe).

III. GJENDJA E MJEDISIT.

a.Kushtet klimatike.

Shqipëria karakterizohet nga një numër i madh zonash klimaterike, krahasuar kjo me sipërfaqen e saj modeste. Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, me dimër të bute dhe verë të lagësht. Temperaturat mesatare variojnë nga 7°C në dimër e deri në 24°C në verë. Pjesa malore karakterizohet nga një klimë mesdhetare-kontinentale, e shkaktuar kjo nga masat ajrore që mbizotërojnë Evropën lindore dhe Ballkanin. Veçori kryesore të kësaj zone janë erërat e fuqishme me drejtimin verior dhe veri-lindor si dhe temperaturat mesatare disi më të ulëta. Sasia e reshjeve është mesatarisht e larte si rezultat i kombinimit të dy rrymave ajrore, ato mesdhetare dhe kontinentale. Niveli i reshjeve varion nga 600 mm në vit në fushëgropën e Korçës, në 3100 mm në vit në Bogë, të Alpeve Shqiptare Këtu, gjithashtu, vlen për t'u theksuar se rreth 95% e shirave të të gjithë vendit bien në sezonin dimëror.

Gjirokastra duke qënë e vendosur në mes ultësirës perëndimore të Shqipërisë dhe asaj malore ne brendesi te territorit, dominohet nga një klimë mesdhetare e nxehtë në verë, siç është normale për Shqipërinë me reshje shumë më të rënda se zakonisht për këtë lloj të klime.

Te dhena klimatike per Gjirokastrën													
Muajt	Jan	Shk.	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shta.	Tetor	Nentor	Dhjet.	Viti
Temp. mes. maksimale °C	9	11	13	18	23	28	32	34	27	23	15	11	20.3
Temp. mesatare ditore °C	5	6	7	12	16	20	23	24	19	14	10	6	13.5
Temp. mes. Minimale °C	1	1	2	6	10	13	15	15	12	8	5	2	7.5
Reshjet mesate mm	290	230	190	90	50	40	10	10	60	180	400	320	1,870

Tab. 1 Te dhena per treguesit baze klimatik per Gjirokastrën.

b. Hidrologjia, cilesia e ujrave.

Lugina e Drinosit ku vendoset qyteti i Gjirokastrës përkohet nga lumi me të njëjtin emër, Drino, (dege e Vjoses). Ky lum kalon në një pjesë të cilës është mjaft e gjere dhe krejt e rrafshet që është pjesë e sipërme e kësaj lugine. Ajo ka toka shumë të mira bujqësore. Në pjesën e poshtme ngushtohet dhe rritet pjerresia e shpatëve.

Ndërsa lumi i Vjoses me të cilin bashkohet ky lum, ka një sipërfaqe ujembledhese prej 6.706 km², 2.154 km² prej të cilave gjenden brenda kufijve të Greqisë, dhe 4552 km² brenda kufijve të Shqipërisë. Prurja mesatare e ujrave në grykëderdhje është rreth 204 m³/s. Në muajin Prill prurja është rreth dhjetë herë më e madhe se në Gusht.

Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lum i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Në rrjetin hidrografik të Gjirokastrës spikat dhe Liqeni i Viroit, i cili ndodhet rreth 5 km larg larg tij, në krah të rrugës nacionale, kur shkon për në Tepelenë. Viroi është një liqen artificial që ushqehet me ujrat që burojnë me vrull nga “Mema”, një burim shumë i thellë, me natyrë karstike, me ujë të kulluar e të pastër. Mendohet se uji i Viroit vjen nga shpella me natyrë karstike e Skotinisë, që ndodhet në fshatin Vanistër në jug të Gjirokastrës, një vend pelegrinazhi dhe njëherësh turistik. Përreth liqenit shpaloset një peizazh i mrekullueshëm i kodrave të gjelbëruara përreth. Viroi është një vend për piknik, për çlodhje, për të eksploruar natyrën nga të apasionuarit e natyrës, studiuesit ose nxënësit e shkollave. Gjithashtu tashmë vizitohet edhe nga shumë turistë të huaj, që vijnë në qytet.

c) Sizmiciteti

Sipas specialisteve është vlerësuar se në territorin e Shqipërisë, me probabilitet 80%, mund të ndodhë një tërmet VII ballë një herë në çdo 5 vjet, një tërmet VIII ballë çdo 10 vjet, ndërsa një tërmet IX ballë çdo 30-40 vjet dhe tërmeti maksimal i mundshëm arrin magnitudën Ms=7.5. Dallohen 9 zonat e burimeve sizmike në vendin tonë ku Gjirokastra futet në zonën e bregdetit Jonian me M_{max} = 7.0.

9 zonat e burimeve sizmike

- Zona Lezhë-Ulqin me M_{max}=7.0

- Ultësira Pranadriatike me $M_{max}=6.9$
- Bregdeti Jonian me $M_{max}=7.0$
- Korçë-Ohër me $M_{max}=6.9$
- Elbasan-Dibër-Tetovë me $M_{max}=6.9$
- Kukës-Peshkopi me $M_{max}=6.5$
- Shkodër-Tropojë me $M_{max}=6.5$
- Pejë-Prizren me $M_{max}=6.8$
- Zona e Shkupit me $M_{max}=6.5$

(“Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik në Shqipëri” Instituti i Sizmologjise, botim 2013),

d. Habitatet, biodiversiteti (flora dhe fauna).

Habitatet

Gjirokastra karakterizohet nga habitate e biodiversitet i shumëllojshëm pasi i përket nderprerjes të ultësirës përendimore me atë të zonës malore kontinentale. Formacionet gjeologjike, variacionet e rilievit, larmia e peizazheve, ujerat, kushtet klimatike, tiparet edafike kanë kondicionu një lloshmeri të pasur biologjike, me vlera turistike, shkencore, kulturore e didaktike. Qarku i Gjirokastrës ka një listë të pasur të monumenteve të natyrës. Falë larmisë së rilievit, Gjirokastra prezanton një spekter të gjere habitatesh (lumore e të rrafshët në të anët e luginës së Drinos, toke e punuar, riliev kodrinore e malor) në të cilin përfshihen një shumëllojshmeri e pasur e organizmave të gjalla që i përkasin faunes së eger si dhe të gjithë elementet floristik.

Veçanërisht vitet e fundit, ky fond i pasur natyror i është nënshtruar një presioni të rritur të aktivitetit njëzror kryesisht në afërsi të zonave urbane e rurale, nga ekspansioni për ndertime duke i tjetërsuar në mënyre të konsiderueshme këtë trashëgimi natyrore.

Zonat e mbrojtura në Qarkun e Gjirokastrës
(Viti 2013, Nentor)

Nr.	Kategoria	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Sipërf. Ha
1	I (Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor)	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102,datë 15.01.1996	
2	II (Park Kombëtar)		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008	34,361.1
3	III (Monument Natyre)	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1,740.0
4		Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1,500.0

Tab: 2. Te dhena për zonat e mbrojtura të Qarkut Gjirokastrë

Flora

Përgjithësisht bimësia natyrore e zonës në shqyrtim karakterizohet nga një larmi llojesh si rezultat i një ndryshueshmërie të kushteve ekologjike e edafike të krijuara nga kombinimi i llojeve të tokës, reshjeve dhe pozicionit topografik.

Shpërndarja e grada e mbulimit të bimësisë dhe gjendja e habitateve pasqyrojnë dhe ndikojnë në veprimtarinë njerëzore sot dhe në të shkuarën.

Në këtë bimesi spikasin dhe drurë fletore të përzierë si dushqet ku midis tyre takohet lisi i butë (*Quercus pubescens*), qarri (*Quercus cerris*) dhe ilqja (*Quercus hex*). Në këto zone takohen gjithashtu drurë të tjerë fletorë si frashëri (*Fraxinus sp.*) shkozat (*Carpinus betulus* dhe *Carpinus orientalis*), panja (*Acer platanoides*) etj.

Bimësia në terrenet gelqerore e veçanërisht në drejtim të paraqitet me grade mbulimi me të ulët dhe dominohet nga ato tipiket për këtë terren si krifsha (*Phillyrea media L.*) dhe merretja dellinja (*Juniperus sp.*), driza (*Paliurus aculeatus*), murrizi (*Crataegus monogyna*) trendafihit i eger (*Rosa sp.*), ferra (*Rubus ulmifolius Schott.*). Gjithashtu ndodhen bime të tjera me të ulët si arsi (*Teucrium polium*), bargjarpëri (*Teucrium chamaedrys L.*), lisra (*Thymus sp.*), trumza (*Satureja montana*) etj.

Fauna

Bota shtazore është mjaft e pasur, por për shkak të nderhyrjeve të njeriut, përgjithësisht

gjendet me e populluar ne zonat me larg qendrave te banuara. Nder popullatat me të stabilizuara janë të dhelprës (*Vulpes vulpes*), ujkut evropian (*Canis lupus*), çakalli (*Canis aureus*) shqarshit (*Martes foina*), nuselalës (*Mustela nivalis*), lepurit (*Lepus europeae*) dhe e iriqit (*Erinaceus concolor*) endemik.

Ne avifaunen e zonës në shqyrtim bejnë pjesë shpende karakteristike te shpateve e luginave kontinentale por dhe te mjedisit urban. Zona është e banuar nga një sërë specimesh zogjsh përfshi turtullin (*Streptopelia turtur*), gardalina (*Carduelis carduelis*), mëllenja (*Turdus merula*), qukapiku i drurit (*Pica sp.*), qyqja (*Cuculus canoris*), grizhla (*Pica pica*), gay (*Carrulus Glandarins*), gushëkuqi (*Erithacus rabeula*), cornix (*Cornus corone cornix*), troglodyte (*Troglodytes troglodytes*), trumcaku (*Passer alosrestica*), Shapka (*Scrolopax rusticola*) etj. Nga grabiqaret takohen me shume skifteret (*Falco tinnunculuse falco peregrinus*).

Janë prezentë gjithashtu ne zonë dhe popullatat e zvarranikëve, përfshi breshkën e rëndomtë (*Testudo hermani*) dhe disa hardhuca (gjarpri-bar *Pseudopus apodus*), hardhucën e gjelbër (*Lacerta viridis*), hardhucën e zakonshme (*Radarcis muralis*), hardhucën e barit (*Podarcis taurica*) dhe gjarpërinjtë përfshirë shigjetën e gjatë (*Coluber caspius*), bollën helmuese (*Malpolon monspessulonus*) dhe nëpërkën (*Vipera ammodytes*).

Zona e lagesht buze lumit Drino, e perrenjet kanë favorizuar popullatat e llojeve të ndryshe të amfibeve si bretkosen e zakonshme (*Rana ridibundo* Pall), thithlopen e zakonshme (*Bufo bufo*), thithlopen e gjelbert (*Bufo viridis* Laur), Triturus vulgaris.

IV. KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT.

Situata aktuale e problemet që adresohen për zgjidhje.

Ne kuadrin e ristrukturimeve të rrjetit shpërndares 6 kV, të rrjetave shpërndares të OSHEE-se dhe të investimeve të reja me fondet e OSHEE-se për qytetin e Gjirokastrës është planifikuar ndërtimi i një fideri të ri shpërndares 20 kV i cili do të lidhet në N/Stacionin Gjirokastra e Re 110/20Kv Gjirokaster. Ky fider i ri do të bëjë të mundur furnizimin me energji elektrike të zonës së mbetur të këtij qyteti.

Avantazhet e rrjetit shpërndares 20 kV kundrejt atij 10 kV, sipas projektit janë:

- **Perdorimi i teknologjise së re dhe bashkohore**
- **Ndryshimi i rrjetave nga egzistues ajrore në rrjet kabllor i cili ka një ndikim pozitiv në infrastrukturen e re dhe në imazhin e qytetit turistik të Gjirokastrës.**
- **Rrit nivelin e tensionit brenda parametrave dhe standarteve ndërkombetare në konsumatore.**
- **Rrit cilësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet qarqeve unazor në konsumator**
- **Ul ndikimet negative në mjedis**

Përshkrimi i rrjetit shpërndares 20 kV që do të ndërtohet, (F3) dhe kabinat e tij.

Ky projekt është hartuar për linjën e re 20 Kv F3 dhe kabinat e tij.

Rrjeti i tensionit të ulët është i përfshirë me daljet e para të tij deri në kapjes e rrjetit TU egzistues ABC.

Përcaktimi i shesheve të ndërtimit të kabinave është kryer sipas qendrave të ngarkesave. Në preventivin e këtij projekti vlera për truallin e kabinave dhe për lejet e ndërtimit nuk është përfshirë.

Sipas projektit, Fideri i ri do të ndërtohet me rrjet kabllor me kablllo XLPE - AL – 3x(1x185) mm². Përdorimi i këtij seksioni është i detyruar sepse një pjesë e rrjetit të këtij fideri është e shtruar me këtë seksion, kablli XLPE AL – 3x(1x185) mm². Kablli do të shtrihet në toke

sipas parametrave dhe standarteve të parashikuara e të percaktuara nga OSHEE. Sipas projektit pika e lidhjes do të jetë N/Stacioni 110/20kV Gjirokastra e Re.

Ne këtë N/Stacion do të montohen 2 Çela të reja 20 KV, me keto karakteristika teknike: Tipi Siemens HA 25.71 me $U_n = 24$ kV, $I_n = 630$ A, $I_{ck} = 25$ kA, $U_{motor} = 110$ v DC. Para se të veprohet duhet të kontrollohen dhe të përshtaten me gabaritet si dhe në menyrën e shfrytëzimit (mbrojtje dhe komandim) të Çelave egzistuese në N/Stacionin 110/20 kV Gjirokastra. (Shih standartin teknik).

Nga N/Stacioni pika “1” deri tek pika “2” kablli është i shtruar dhe është gati për t’u përdorur, para se të futet në punë të kontrollohet për nivelin e lagështisë dhe izolimin pastaj të behën 3 mufta njëfazore ku të lidhet me kabllin e ri 20 kV në drejtim të kabinës K1/F3 Divizioni.

Para fillimit të punimeve duhet të merren lejet e punimeve dhe të ribehet azhurnimi i trasesë së linjës për të riparë strukturat e trasesë nga ndryshimet e mundshme që mund të ketë pësuar dhe të merren lejet në Institucionet përkatëse (Bashki, Telecom, Ujësjetës, etj). Për çdo ndryshim të projektit duhet të merret leje nga projektuesit.

Fideri 3 do të jetë i gjatë 6200 m dhe do të furnizojë 16 kabina nga keto 4 kabina janë rikonstruksion ndërsa 12 kabina të tjera të jenë kabina 20/04 KV parafabrikat Tip BOX. Ky fider përfundon dhe do të lidhet në pikën fundore në kabinën k16-F4 Partizani që do të jetë kabina e fundit e fiderit tjetër F-4 i cili do të ndërtohet në fazën e dytë dhe kjo kabina do të jetë për pikën paralel midis F3 dhe fiderit F4.

Kabinat e reja do të jenë të gjitha parafabrikat Tip BOX me bazament të inkorporuar sipas standartit të miratuara nga OSHEE.AI. (Sipas specifikimeve teknike të OSHEE.AI).

Furnizimi i kabinave do të realizohet sipas skemes klasike hyrje-dale.

Demontimet për linjat egzistuese 6 kv, kabinat shtyllore 6/04 kV si dhe ndonjë linjë TU egzistuese pronë e OSHEE.AI, të cilat pasi të futet në efikasë fideri F3 dhe kabinat 20 kV që do të ndërtohen rikonstruktohen, nuk do të jenë me efikasë do të realizohen nga punonjësit e Drejtorisë Zonale Gjirokaster me Urdhër nga Drejtoria.

Në kalimet tek strukturat anësore të rrugëve të betonuara kabllot do të kalojnë anash strukturave të betonuara, dhe do të futen në tub PE me seksion me diametër 160 mm^2 , $t=11.8$, PN 10 e cila do të mbështet në rikonstruksione metalike me ele Tip 50x5 mm, të cilat do të përseriten çdo 2 m. Në dy skajet e tubit do të ndërtohen puseta në menyrë që të fleje kablli. (Shikoni detajet teknike në fletën e vizatimit “00”).

Në kalimin e Urës së Zingjirave nga puseta “P/15” e cila do të çahet dhe kabllot do të kalojnë anash murit dhe parrmakut të urës deri në pusetën “P13” të futura në tubo llamarine fresibel me diametër 200 mm^2 dhe brenda tij do të futet një tub PVC fleksibel me diametër 160 mm^2 L= 1x20m, e cila do të mbështet në konstruksione metalike me ele Tip 50x5 mm të cilat përseriten çdo 2 m.

Ne çdo intersektim me kanalet e ujereve dhe tombino uji, kablli do të vendoset në tub PE me seksion me diameter 160 mm^2 , $t=11.8$, PN 10 dhe tubi PE do të mbështetet në jastek betoni sipas specifikimeve të vendosura në projekt.

Sipas projekti, në rrugët kryesore me kalldrem janë ndertuar puseta të reja në menyrë që të kemi një zgjidhje definitive për shfrytezimin e linjave dhe në raste të tjera difektsh.

Në të gjitha intersektimet e rrugeve kryesore kablli do të vendoset ne tub plastik PVC me diamëter 200 mm^2 me parete të plota i cili do të fleje në një shtresë betoni sipas specifikimeve të vendosura në projekt, por gjithmonë duke respektuar kushtet teknike në fuqi.

Ne intersektimet e rrugeve jo kryesore, kablli do të futet ne tub plastik PE me diameter 200 mm^2 me parete të plota.

Ne fleten e pare të projektit janë paraqitur prerjet tërthire për të gjitha rastet e shtrirjes se kabllit. Punimet të kryhen duke zbatuar përmasat dhe shtresat e dhena në profilet e prerjes se kanaleve.

Gjatë të gjithë gjatesisë së kabllit në kanal të vendoset shirit emertues, i miratuara nga OSHEE.AI dhe të kete logon e shkruar “OSHEE.AI”.

Në të gjitha rastet rrezja e harkut të kabllit nuk duhet të jetë me e vogël se 12 fishi i diametrit të jashtem të tij. Prandaj është mirë që traseje e kabllit të mos krijoje kende të ngushta dhe të drejta.

Muftet bashkuese dhe kokat e kabllit të behen ne kushte të mira atmosferike dhe mbi to të mos ushtrohen sforcime mekanike. Muftet ne kanal të mbrohen dhe të sigurohen me tre shtresa me tulla ne një gjatesi 2 ml. (shih specifikimet teknike).

Punimet të kryhen nën mbikqyrjen e përsoneve fizik ose juridik të paisur me çertifikata profesionale përkatëse.

Gjatë kryerjes se punimeve për zbatimin e projektit të zbatohen kushtet teknike të shtrirjes së kablllove ne kanal si dhe të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik.

A. Ndertimi i rrjetit shperndares 20 kV. Shtrirja e instalimi i kabllit

Duke ju referuar projektit duhet te zbatohen keto kritere teknike per rastet e kryqezimeve te kablllove me tubacionet metalike:

- Ne rastin e kryqezimit te kablllove TM me tubacione metalike, distance minimale ndermjet tyre nuk duhet te jete me pak se 0.5 m. Kjo distance mund te reduktohet deri ne 0.3 m. Ne rast se ndermjet tyre vendoset element mbrojtes jo metalik qe zakonisht eshte nje pllake betoni, ose kur tubi metalik eshte i future ne nje tub izolues duke respektuar si ne figurat perkatëse.




Fig. nr. 3
Kryqezimi i
kablrit me
tubacione
metalike

- Nuk lejohet që kabli TM të kalojë mbi pjesën ku është bërë bashkimi i tubacioneve metalike, në rastet kur ky bashkim është bërë pa saldim.
- Distanca minimale në planin horizontal, ndërmjet muftëve të kabllave të TM dhe tubacioneve metalike nuk duhet të jetë më pak se 1m. Kjo distancë mund të reduktohet në rast se ndërmjet kabllit dhe tubacionit metalik vendoset një pllakë prej elementi jo metalik që zakonisht është pllakë betoni sikurse tregohet në figurë.
- Gjate kryqezimit me tubacionet e nxehta distanca nuk duhet të jetë më e vogël se 0.5m.
- Specifikimet e mesiperme nuk vlejnë për tubacionet e gazit pasi kanë specifikime të tjera.

Kabllot paralele me tubacionet metalike

- Gjithmone duhet të synohet që kabllot e energjisë dhe tubacionet metalike të vendosen sa më larg që të jetë e mundur. Distanca ndërmjet tyre në projektim horizontal, nuk duhet të jetë më e vogël se 0.3m. Kjo distancë duhet të reduktohet, në qoftë se distanca në planin vertical është më e madhe se 0.5m. Gjithashtu kjo distancë mund të reduktohet edhe në qoftë se distanca në planin vertical është nga 0.3m në 0.5m por me kusht që ndërmjet tyre të vendoset një element ndares jo metalik si për shembull një pllakë betoni.
- Në rastin e tubacioneve të nxehta largësia ndërmjet kabllit dhe tubacionit nuk duhet të jetë më e vogël se 2m.

- Specifikimet e me sipërme nuk vlejne per tubacionet e gazit pasi kane specifikime te tjera.

Me kabllot telefonike

- Kabllot e TM dhe ato te telefonise duhet te vendoset sa me larg te jete e mundur (ku eshte e mundur ne te dy anet e ndryshme te rruges), ne te kunder lejohet qe ato te vendosen afer, por gjithmone ne nje distance jo me te vogel se 0.3m. Kjo distance mund te reduktohet ne qofte se kablli telefonise mbrohet ne kasete metalike inoksi ose çeliku te zinguar ne te nxehte me spesor jo me te vogel se 2mm dhe diferenca e kuotes eshte jo me e vogel se 0.15m.





Fig. nr. 4 Kalimi i kabllit parallel me ate elektrik

- Edhe kjo distance e differences se kuotes mund te reduktohet, ne qofte se edhe kablli i energjise vendoset ne kasete mbrojtese, zakonisht mund te perdoret ne vend te mbrojtetes prej inomksi ose çeliku, kasete betoni.
- Keto mbrojtese mund te eliminohen ne qofte se te pakten njeri nga kabllot eshte ne nje pajisje mbrojtese qe te lejon mirembajtjen pa bere germime.

Fig nr. 5

KALIMI I KABLLOVE TE FIDERIT 20 kV NR.3 ANASH URES OSE NE RRUGE ME DISNIVEL NE TUB PVC



Shtirja e kabllit ted y fiderave 20 kV gjate rrugeve me kalldrem, çakell, asfalt etj.

Fig. nr. 6 PRERJA TERTHORE E KANALIT PER SHTRIRJE TE DY FIDERAVE 20 KV GJATE RRUGEVE ME KALLDREM.




Fig. nr. 7 PRERJE KANALI TIP PER SHTRIRJE NE KRYQEZIME ME RRUGE ME ASFALT PER 2 FIDERA 20 kV, ME KABELL AL XLPE 185 mm²




Fig nr. 8 PRERJE KANALI TIP PER SHTRIRJE NE KRYQEZIMET ME RRUGE ME ÇAKELL PER 2 FIDERA 20 kV, ME KABELL AL XLPE 185 mm²




Fig nr. 9

PRERJA TERTHORE E KANALIT PER SHTRIRJE TE FIDERIT
20 KV GJATE RRUGEVE ME KALLDREM.





Fig nr. 10

NDERPRERJA E NJE LINJE KABLDRE 20 KV ME
TOMBINO UJRASH






Fig. nr. 11
 Planimetria
 Zhvillimi i rrjetit
 TM 20 kV, F3,
 N/ST110/20kv
 Gjirokaster

Fig. nr. 12 Projekti i linjes kablore dhe kabinave per F3, 20 KV, nga N/S 110/20KV Gjirokaster, segmenti nga pika "9" deri tek kabina tip kulle Partizanti K16-F4.




Fig. nr.13 Projekti i linjes kablore dhe kabines BOX per F\$, nga N/S 110/20 KV Gjirokaster, segmenti nga pika “2” deri tek kabina rikonstruksion “K7-F4 29 Nentori”.





Fig. nr. 14 Skema principale e rrjetit 20kv te fiderave te rinje F3 e F4 nga N/S Gjirokatra.



B. Rikonstruksioni i kabinave

Per rikonstruksionin e kabinave do te realizohen keto aktivitete ndertimore:

- Prishja e suvatimit te demtuar dhe suvatimi i ri si brenda dhe jashte kabines.
- Mbushja me zhavor lumi $h=30\text{cm}$ e dyshemese se kabines.
- Shtrimi i dyshemese $h=10\text{cm}$ me shtrese betoni.
- Hapja e kanaleve te kablllove sipas projektit.
- Betonimi i kanaleve te kablllove.
- Vendosja e pllakes $50 \times 50 \times 5$ per mbulimin e kanalit te kablllove.
- Lyerja e kabines me tre duar gelqere nga brenda dhe me hidromat nga jashte.
- Lyerja me boje vaji e dyerve dhe konstruksionet metalike.

Per rikonstruksionin e kabinave sipas projektit do te realizohen ne aspektin elektrik:

- Demontimi i izolacionit 6kv.
- Ndriçimi i kabines.
- Montimi me izolacion 20 kv i kabines sipas projektit te paraqitur.
- Realizimi i tokezimit te kabines per nje rezistence tokezimi $R.T. \leq 2 \cdot \Omega$.

Nr	Baza materiale kabina "K.14"	Njesi	Sasia
1	Freskore (zhaluzi)	cope	1
2	Cela linje	cope	2
3	Cela transformatori	cope	1
4	Transformator 400kva, 20/04kv	cope	1
5	Panel tu me kater dalje	cope	1
6	Kabell xlpe 3x 1x185 mm ²	ml	30
7	Ura tu xlpe 1x70 mm ²	ml	21
8	Ura tu xlpe 1x240 mm ²	ml	49
9	Terminale 20kv	cope	12
10	Kapikorda cu-al 240	cope	7
11	Elektroda tokezimi	cope	6
12	Shirit tokezimi 40x4	ml	40
13	Rrjete teli e godronuar	m ²	8.75
14	Mufe 6 kv unipolare	cope	3

Tab. Nr. 3

Fig. 15 Skema elektrike qe do te zbatohet per rikonstruksionin e kabinave.




Fig. 16 Rikonstruksioni i Kabines K.9 (Granice) F.3

dhe Kabines K.13 (Palorto 1) F.3





Fig. 17 Rikonstruksioni i Kabines K.14 (Palorto 2) F.3 dhe i Kabines K.15 (Kerculle) F.3






Fig.18 Rikonstruksioni i Kabines K.16 (Partizani) F.4



C. Instalimi i Kabinave TIP BOX


Sipas projektit evidentohen keto aspekte teknike te kabinave Tip BOX

- Per instalimin e kabines ne rrjet duhet te germohet nje grope drejtkendore ne perputhje me standartet e OSHEE sh.a.
- Pas perfundimit te germimit te gropes, toka duhet te ngjeshet.
- Dyshemeja e gropes te mbushet me nje shtrese zhavori $H=100\text{mm}$.
- Ne tokat ujembajtese te ndertohtet nje system drenazhimi per rreth gropes.
- Punimet te zbatohen nen mbikeqyrjen e personave te pajisur me licensat perkatese.
- Te zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik.

Fig. nr. 19 Pamja ballore dhe bazamneti i kabines Tip BOX






Prerja A-A e kabines TIP BOX



PERSHKRIMI I MATERIALEVE	
1- TR Fucle	
2- Paneli TM (Celat)	
3- Paneli TU	
4- Mure Ndares	
5- Dera e ambientit te Transformatori	
6- Dera e ambientit te paneleve	
7- Zakuzi	

<p>OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGISJE ELEKTRIKE</p> <p>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT ZHVILLIMIT PROJEKTIMIT DHE STANDARTIZIMIT</p> <p>ZHVILLIMI I RRJETIT TM 20 KV FIDERI F3 NENSTACIONI 110/20 KV GJIROKASTER</p> <p>PRERJA A-A E KABINES TIP BOX</p> <p>Porositës : Drejtoria Rajonale Gjirokaster</p>	DREJTORI/DISH		
	DREJTOR/DZPZS		
	PROJEKTUES		
	PROJEKTUES		
	Shk. 1: 25	PROJEKT-ZBATIM	
	Nr.FLETES		E-10-10/3
	DT. 2015		



<p>OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGISJE ELEKTRIKE</p> <p>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT ZHVILLIMIT PROJEKTIMIT DHE STANDARTIZIMIT</p> <p>ZHVILLIMI I RRJETIT TM 20 KV FIDERI F3 NENSTACIONI 110/20 KV GJIROKASTER</p> <p>PRERJA A-A E KABINES TIP BOX</p> <p>Porositës : Drejtoria Rajonale Gjirokaster</p>	DREJTORI/DISH		
	DREJTOR/DZPZS		
	PROJEKTUES		
	PROJEKTUES		
	Shk. 1: 30	PROJEKT-ZBATIM	
	Nr.FLETES		E-10-10/4
	DT. 2015		

SKEMA ELEKTRIKE PRINCIPALE




DIAGRAMA 3-FAZORE E PANELIT TE TENSIONIT TE ULET

PANEL TU (1X630+4X160)A


 <p>OPERATORI I SHËRËNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE</p>		DREJTORI/DISH	
		DREJTORI/DPZS	
<p>DREJTORIA E PLANIFIKIMIT ZHVILLIMIT PROJEKTIMIT DHE STANDARTIZIMIT</p>		PROJEKTUES	
		PROJEKTUES	
<p>ZHVILLIMI I RRJETIT TM 20 KV FIDERRI P3 NE NSTACIONI 110/20KV CAIROKASTER</p>		SHK. I. 30	PROJEKT-ZBATIM
		NA.FLETES	
Porositës :	Drejtoria Rajonale Gjirokaster	DT. 2015	E-10-10/5

D. Daljet e para te linjave TU

Sipas projektit, linjat ajrore me percjellesa te izoluar me vetembajtje ABC, sherbejne per te furnizuar me energji elektrike abonente nje dhe tre fazore nepermjet percjellsave ABC me vetembajtje me izolim XLPE te fiksuar ne shtylle me aksesoret perkates. Per mbajtjen e kabllit perdoren tirantuesa ankerore, ne shtyllat fundore ose ankerore dhe tirantues ndermjetes ne shtyllat ndermjetese. Tirantuesit fiksohen tek aksesoret shtyllore. Per rastin e kabllave te aluminit, ne tirantuesin ankerore ose ndermjetes fiksohet i gjithe kablli ose vetem percjellesit te neutrit ne vartesi te llojit te tirantuesit te perdorur. Per kabllot e bakrit ne tirantues fiksohet detyrimisht i gjithe kablli. Aksesori shtyllor per abonentin montohet 20-25 cm me poshte se aksesori shtyllor. Lidhja elektrike e percjellsave behet me nyje lidhese te izoluar. Ndermjet dy tirantuesve ankerore, qe ndodhen ne dy ane te ndryshme te shtylles, kablli ka forme te harkuar me gjatesi jo me te vogel se 80 cm, me qellim qe te lejoje vendosjen e nyjeve izoluese ne qofte se ne te njejten shtylle lidhen dy apo me shume abonente duhet qe distance ndermjet kabllave koaksiale qe ndodhen prane njeri tjetrit te mos jete me e vogel se 20 mm. Gjithashtu duhet qe distanca ndermjet dy skajeve te brendshme te nyjeve izoluese (distance me e afert ndermjet dy nyjeve fqinje) te vendosura ne te njejten faze (apo ne neuter), te mos jete me e vogel se 50 mm.

Fig nr. 20


DETAJE PER FUNIZIMIN E ABONENTEVE NGA LINJAT KABLLORE TE TU ME PERCJELLES ABC



Linjat ajrore me percjellsa te izoluar me vetembajtje ABC, sherbejne per te funizuar me energji elektrike abonente nje dhe tre fazore nepermjet percjellsave ABC me vetembajtje me izolim XLPE te fiksuar ne shtylle me aksesoret perkates. Per mbajtjen e kabllit perdoren

tirantuesa ankerore, ne shtyllat fundore ose ankerore dhe tirantues ndermjetes ne shtyllat ndermjetese. Tirantuesit fiksohen te aksesoret shtylllore. Per rastin e kablllove te aluminit, ne tirantuesin ankeror ose ndermjetes, fiksohet i gjithe kablli ose vetem percjellsi i neutrit ne vartesi te lloit te tirantuesit te perdorur. Per kabllot e bakrit ne tirantues fiksohet detyrimisht i gjithe kablli. Lidhja elektrike e percjellesave behet me nyje lidhese te izoluara. Ndermjet dy tirantuesve ankerore, qe ndodhen ne dy ane te ndryshme te se njejtes shtylle, kablli ka forme te harkuar me gjatesi jo me te vogel se 80 cm, me qellim qe te lejoje vendosjen e nyjeve izoluase.

Fig nr. 21 **DETAJE PER SHTRIRJEN E KABLLOVE TE TU ABC**



Nr	Baza materiale kabina K1-F3 Divizioni	Njesia	Sasia
1	Kabell XLPE Al 4 x 95 mm ²	ml	80
2	Percjellsa ABC Al – 4x95 mm ²	ml	227
3	Xhunto TU	ml	0
4	Shtylla B/A 9/6 (ml/kN) te reja	cope	3
5	Shtylla B/A 9/15 (ml/kN) te reja	cope	2
6	Elektroda tokezimi	cope	4

Tab. 4. Materialet qe nevojiten per sistemimin e dalje TU.

Per permirsimin e furnizmit me energji elektrike te qytetit te Gjirokastrës eshte hartuar projekti i ndertimit te fiderit te ri kabllor 20 kV dhe kabinat e reja Tip BOX te tij, nga N/Stacioni 110 kV Gjirokaster. Per kete arsye eshte hartuar edhe projekti i sistemimit te daljeve te para TU te kabinave te reja BOX si dhe kabinave te cilat do te zevendesojne kabinat shtyllore.

1. Projekti ka pasqyruar edhe sistemimin e daljeve TU per kabinat BOX.
2. Daljet e para do te realizohen me kabell TU XLPE Al 4 x 95 mm².
3. Shtyllat e reja do te vendosen te tipit Beton/arme 9mlx6 /KN dhe 9 ml/15 KN.
4. Do te behet tokezimi I perseritur I neutrit sipas projektit. Rezistenca e tokezimit te jete $\leq 10 \Omega$.
5. Kabinat do te behet me 3 dalje TU.
6. Gjate zbatimit te projektit duhet te merren masat e sistemimit te rrjetit ekzistues 6 kV per ruajtjen e distancave ne kryqezimin e linjave ajrore TM dhe TU.
7. Te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te montimit te kabllit ABC ne shtylle sipas rregullores se sigurimit teknik.
8. Gjate lidhjes se aboneteve te behet simetrizimi i ngarkesave ne fazat e sejciles dalje ABC. Te kihet parasysh ndarja e rrjeteve TU ne rastet e futjes se kabinave te reja tip BOX ne menyren qe te kete nje shperndarje te plote te ngarkesave.




Fig. nr.22 Ngritja e kabllit ne shtylle dhe tokezimi i shtyllave

Fig. nr.23 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjrokaster, Kabina K1-F3 Divizioni me transf. 400 kVA.




Fig. nr.24 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjrokaster, Kabina K2-F3 Grihoti me transf. 400 kVA.




Fig. nr. 25 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K3-F3 me transformator 400 kVA.




Fig nr. 26 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K4-F3 ALIZANI me transf. 400 kVA.




Fig. nr.27 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K7-F3 Mene me transformator 400 kVA.






Fig. nr.28 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K6-F3 Mene me transf. 400 kVA.



LEGJENDE

- Kabina Box e re
- Kabina egz. shtyllore
- Kabina egz. murature
- Sht ekzistuese TU
- Sht e re B/A 9/6(ml/kN)
- Sht e re B/A 9/15(ml/kN)
- Dalja kablore XLPE
- Dalja 1 ABC
- Dalja 2 ABC
- Dalja 3 ABC
- Dalja 4 ABC

Fig. nr. 29 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K7-F3 Arqile me transformator 400



kVA.

Fig. nr.30 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K8-F3 Granica me transf. 400 kVA.




Fig. nr. 31 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K10-F3 Enver Llaka me tr. 400 kVA.




Fig. nr.32 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K11-F3 Granica 1me transf. 400 kVA.




Fig. nr.33 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K12-F3 Granica 3 me trans. 400 kVA.




Fig.nr.34 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K16-F3 Dunavat me transf. 400 kVA.




Fig. nr. 35 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K1-F4 Sigurimet me transf. 400 kVA.





Fig. nr. 36 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K2-F4 Anesti Kosta me transformator 400 kVA.





Fig.nr. 37 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K4-F4 11 Janari 2 me transf. 400 kVA.





Fig. nr. 38 Daljet e para per sistemimin e rrjetit TU per kabinat e reja TIP BOX te fiderit te ri 20 kV F3 N/Stacioni 110/20 kV Gjirokaster, Kabina K5-F4 Pedagogjike me transf. 400 kVA.



TE DHENA PERMBLEDHESE MBI PROJEKTIN

Projekti ka te beje me ndertimin e rrjetit te tensionit te mesem 20 kV ne qytetin e Gjirokastrës, ne pjesën e mbetur te tij. Ne projekt eshte perfshire ndertimi i linjave TM 20 kV, i kabinave te transformacionit 20/0.4 kV, dhe i daljeve te para TU.

Sipas projektit, Fideri i ri do ndertohen me rrjet kabllor me kablllo XLPE - AL – 3x(1x185) mm². (Nga N/Stacioni pika “1” deri tek pika “2” kablli është i shtuar dhe është gati për t’u përdorur). Fideri 3 do të jetë i gjatë 6200 ml dhe do të furnizojë 16 kabina nga keto 4 kabina janë rikonstruksion ndersa 12 kabina të tjera të jenë kabina 20/04 KV parafabrikat Tip BOX.

Do te behet demontimi për linjat egzistuese 6 kv, kabinat shtyllore 6/04 kV si dhe ndonjë linjë TU egzistuese pronë e OSHEE.AL. (Demontimi do të realizohen nga punonjësit e Drejtorisë Zonale Gjirokaster me Urdhër nga Drejtoria dhe për këtë arsyes nuk janë përfshirë në preventivin e këtij projekti).

Gjate kesaj faze do të behet rikonstruksioni i kabinave GRANICA K9/F3, PALORTO 1 K13/F3, PALORTO 2 K14/F3, dhe KERCULLA K15/F3.

Ne dy skajet e tubit PE (me seksion me diamtër 160 mm², t=11.8, PN 10 e cila do të mbeshtet në rikonstruksione metalike me ele Tip 50x5 mm, të cilat do të përseriten çdo 2 ml) do të ndertohen puseta në menyrë që të fleje kablli. Kjo do te behet në te gjitha kalimet tek strukturat anesore të rrugeve të betonuara.

Fiksimi i tubove ne muro në kalimin e Urës së Zingjirave nga puseta “P/15” e deri në pusetën “P13” .

Realizimi i intersektimeve ne kanalet e ujrave dhe tombino uji, vendosja e kabllit në tub PE me seksion me diameter 160 mm², t=11.8, PN 10 dhe tubi PE i cili do të mbeshtetet në jastek betoni sipas specifikimeve të vendosura në projekt.

Janë ndertuar puseta të reja në rrugët kryesore me kalldrem në menyrë që të ketë një zgjidhje definitive për shfrytezimin e linjave dhe në raste të tjera difektesh.

Do të vendoset shirit emertues, gjatë të gjithë gjatesisë së kabllit në kanal, i miratuara nga OSHEE.AL dhe të kete logon e shkruar “OSHEE.AL”.

Muftet bashkuese dhe kokat e kabllit të behen ne kushte të mira atmosferike dhe mbi to të mos ushtrohen sforcime mekanike. Muftet ne kanal të mbrohen dhe të sigurohen me tre shtresa me tulla ne një gjatesi 2 ml. (shih specifikimet teknike).

Punimet të kryhen nën mbikqyrjen e përsoneve fizik ose juridik të paisur me çertifikata profesionale përkatëse.

Gjatë kryerjes se punimeve për zbatimin e projektit të zbatohen kushtet teknike të shtrirjes së kablllove ne kanal si dhe të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik.

Kerkesa me karakter teknik e organizativ qe duhet te zbatohen sipas projektit.

- Percaktimi i shesheve te ndertimit te kabinave eshte kryer sipas qendrave te ngarkesave dhe me miratim te bashkise Sarande.
- Para fillimit te punimeve te meren lejet e punimeve dhe te meren lejet ne institucionet perkatese (Bashki, Telecom, Ujesjelles, etj.) sipas legjislacionit ne fuqi.
- Vendosje ne formacion te drejte te distancuar nga njeri tjetri (Shih projektin) gjithmone te ruhet struktura e rruges ne te cilen eshte shtrire linja kabllore.
- Gjate zbatimit te projektit te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te shtrirjes se kablllove ne kanal.
- Ne te gjitha intersektimet e rrugeve kablli do te vendoset ne tub PVC me parete te trasha, sipas specifikimeve te vendosura ne projekt.
- Gjate gjithë gjatesise se kabllit ne kanal te vendoset shirit emertues (Shih standartin).
- Demontimet e linjave 6 kv, kabinat shtyllore 6/04 kV si dhe ndonjë linjë TU egzistuese do te kryhen nga punonjesit e OSHEE-s te njesia Gjirokater pasi te jete bere zbatim i plote i ketij projekti. (Me urdher nga drejtoria)
- Gjate kryerjes se punimeve te zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytezimit teknik.
- Para fillimit te punimeve te njoftohen subjektet private qe nuk jane perfshire ne kete projekt qe te marin masa per ndryshimin e izolacionit te kabinave ne pronesi te tyre. Per njoftimin e tyre ngarkohet njesia Gjirokater.
- Te behet tokezimi i kabinave dhe te arrihet rezistenca e tokezimit sipas projektit.

Zera punimesh qe kane ndikim direkt ose indirekt ne mjedis:

- Prerje asfalti me disk;
- Prishje struktura prej betoni Germ. shkemi i forte me çekiç me ekskav. me zinxhir;
- Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m;
- Germim shkemi i forte me çekiç me eskavator me zingjir;
- Transport dheu me auto;
- Shtrese betoni C 16/20 per shtrim tubosh PVC me paret $\delta = 3.2$ mm;
- F. V. Hekur betoni i zakonshem $\varnothing 6 \sim 10$ mm (zgare ne kanal);
- F.V. Marketim kablllo e tabela sinjalizimi;

- Transport Autovinxh 5 ton per materiale i materialeve elelektrike;
- Shtrese stabilizant h = 10 cm;
- Shtrese zhavor lumi h = 20 cm;
- F.V.Shtrese tulla te plota (rate) mbi rere;
- Shtrese zhavor lumi h = 30 cm;
- F.V. Shtrim shirit emetues PVC ne kanal;
- Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur;
- Shtrese binderi me granil gur kave,7 cm,me makineri;
- Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri;
- F.V. Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura;
- Shtrese betoni C 16/20 per trotuar;
- Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka;
- Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m;
- Shtrese rere ne kanal h = 10 cm;
- Shtrese betoni C 16/20 per jastek kokash tubi (0.5 m³ per koke);
- Shtrese rere ne kanal h = 20 cm;
- Tubo PVC Ø = 200 mm δ = 3.2 mm;

VI. ORGANIZIMI I PUNES.

Realizimi i projektit "Zhvillimi i rrjetit TM 20 kv fideri F3, Nenstacioni 110/20kv Gjirokaster", duhet të behet sipas periudhave specifike kohore që synojnë nderprerjen në afate sa më të shkurtra të energjisë për abonentet duke respektuar gjithashtu kushtet teknike të sigurisë në punë.

Të gjithë abonentet duhet të njoftohen me parë për periudhat e nderprerjes së energjisë për marrjen e masave përkatëse të sigurisë e plotësimit të nevojave të tyre.

Gjatë gjithë periudhës së kryerjes së aktivitetit e në të gjithë vendin ku punohet duhet të vendosen të gjitha tabelat treguese e sinjalizuese e shirita kufizuese e orientues të levizjeve, për sigurinë në punë gjatë fazës së zbatimit të projektit. Po kështu ngarkohen punojës sipas rastit për të komunikuar me kalimtarët e drejtuesit e automjeteve për qëllime sigurie të jetes se tyre e të pronës. I gjithë aktiviteti organizohet dhe në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokaster dhe sipas rastit me përfaqësues të subjekteve të albetelekomit e ujesjellesit si dhe nga administratoret e objekteve turistike.

VII. NDIKIMET NE MJEDIS.

a) Mbetjet e ngurta.

Gjatë punimeve të hapjes së kanaleve për vendosjen e kabllave elektrik në të gjitha rastet si në rrugë kalldrem, në rrugë të asfaltuar, në rrugë me çakell, në trotuar me beton, në trotuarë me pllaka, poshtë trotuarit, intersektimet në kanale uji e tumbino, në anë të ures së Zingjirave, do të krijohen sipas rastit mbetje të ngurta.

Gjate demontimit të kabinave krijohen mbetje të ngurta të natyrës ndertimore. Po kështu heqja e levizja e shtyllave centrifuge të drmtuara, izolatoreve të plasaritur e të demtuar do të administrohen mbetje. Traversat e vjetra që mbeten pas demontimit, shtylla që formohen gjate demontimit të cilat janë të pademtuara mund të përdoren për nevojat e OSHEE për riparimet të pjesëshme në rrjetat 6/10 kV që disponon Drejtoria Rajonale. Aktiviteti i zhvillimit të rrjetit TM 20 kV Gjirokaster, nuk ka të bëjë me shëndrrime potenciale të lëndëve të ndryshme që përdoren gjate punimeve e që të shoqërohet më formime të mbetjeve të tjera ose të emetimeve më natyrë ndotese.

b) Shkarkimet në ujrat sipërfaqesore e nëntoksore.

Aktiviteti i zhvillimit të rrjetit TM 20 kV Gjirokaster, nuk ka të bëjë me shëndrrime të lëndeve të ndryshme e që të shoqërohet me administrim të substancave të lengeshme ose ujrave të përdorshme e që të krijojë situata nën rrisht për ujrat sipërfaqesore e nëntoksore.

c) Ndikimet ne ajer.

Gjatë kohës kur kryhen veprime operacionale demontuese e instaluese, kanalizimeve për trasene, ku kërkohet aktivizimi i makinerive, pajisjeve e automjeteve si autovinç, apo automjetet qe ofrojne kabina e pajisje mbrojtese per kryerjen e punimeve, ndikohet në emetimet në ajër nga produktet e djegies të karburantit nga motoret. Keto emetime konsiderohen brenda standarteve të lejuara pasi dhe makineritë motorrike e automjetet duhet të plotësojnë kriteret e të mos jenë të amortizuara. Produktet e djegies se karburantit gjate qarkullimit e manovrave të automjeteve jane te zakoneshme dhe punojne si te tilla vetem ne mjedise te hapura. Hapja e kanalizimeve e zhvillimi i trasese, punimet rehabilituese për rrugen (shtrimet me pllaka, betonimet, asfaltimet etj) do të shoqërohen me emetime te plurave (rritja e grimcave te pezullta ne ajer). Gjate venies ne pune të linjes se re nentoksore sa me siper pershkruar nuk kemi te bejme me emetime te ndotesve ne ajer.

Gjate aktivitetit nuk ka asnje proces tjetër shkarkimi ne ajer.

d) Zhurmat.

Aktiviteti ka të bëjë me zhurmat që shkaktohen nga puna e makinerive e pajisjeve qe kryejne punime si dhe e automjetet gjatë levizjës për transport të matërialeve ndertimore e pajisjeve elektrike. Situata behet me e ndjeshme pasi disa punime behen pranë objekteve turistike, rezidenciale ose objekte sherbimi. Në mënyrë të veçantë akoma me e ndjeshme do të ishte situata në periudhat e pikut të frekuntimit nga

turistet gjatë stinës së ngrohtë. Aktiviteti sipas projektit nuk ka të bejë me ndikime potenciale nga zhurmat në mjedis.

dh). Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu.

Zhvillimi i rrjetit TM 20 kv fideri F3, Nenstacioni 110/20kv Gjirokaster, nuk ka të bëjë me ndikime negative tek njerezit, ndertesat dhe objektet të tjera. Do të ketë vetëm ndikime të përkohshme në përqëndrimin e situatës mjedisore që ka të bejë me hapjen e kanalizimeve për kabllot elektrik, ndertimit të bazamenteve të kabinave elektrike.

Nderhyrjet e planifikuara sipas projektit në këto zone do të ketë impakte pozitive të ndjeshme si vijon:

- Nje rrjet elektrik TM ne pjesen e mbetur te qytetit turistik të Gjirokastrës, sipas parametrave te OSHEE, perdoret teknologji e re dhe bashkohore.
- Rrit cilesine dhe sigurine e furnizimit me energji elektrike nepermjet qarqeve unazor ne konsumator
- Rrjeti vihet plotesisht nen kontrollin e punonjesve te Drejtorise Rajonale Gjirokastrë.
- Ndryshimi i rrjetave nga egzistues ajror ne rrjet kabllor i cili ka nje ndikim pozitiv ne infrastrukturen e re dhe ne imazhin e qytetit turistik te Gjirokastrës.
- Rrit nivelin e tensionit brenda parametrave dhe standarteve nderkombetare ne konsumatore.
- Ulen ndikimet negative ne mjedis.

e) Ndikimet ne toke, ne klime, ne floren, faunen dhe gjeologjine.

Realizimi i projektit " Zhvillimi i rrjetit TM 20 kv fideri F3, Nenstacioni 110/20kv Gjirokaster ", ne pjesën e mbetur te qytetit të Gjirokastrës, nuk ka të bëjë me ndikime negative ne toke, ne klime, ne floren, faunen dhe gjeologjine. Aktiviteti ka të bejë me standartizimin bashkëkohor të rrjetit për shperndarjen e energjisë elektrike. Gjatë procesit të kryerjes se nderhyrjeve ka ndikime të pjeseshme të përkoheshme ne hapjen e kanaleve ne rruget me kalldrem, me çakull ose asfalt si dhe ne trotuare, ne

intersektimet e rrugëve e kanaleve, për futjen e kabllit nëntoksor. Largimi i dherave të teperta pas hapjes së kanaleve mund të përdoret si mbushës në aktivitetin ndërtues. Vetëm gjatë kryerjes së demontimeve të rrjetit do të ndikohet në mënyrë të përkohshme në prishjen e qetësisë së elementeve faunistik në vendet ku linja kalon në mjedise të gjelberuara por pa efekte negative të qëndrueshme.

ë) Ndikimi në infrastrukturen urbane të zonës.

Nderhyrjet që bëhen në rrjetin elektrik në zonën e projektit, prek në mënyrë të përkohshme vetëm sipërfaqe të caktuara në rrugë me kalldrëm, çakëll e asfalt, trotuare, gjatë intersektimeve ndërsa nuk prek asnjë element tjetër të infrastruktures së zonës. Ky projekt merr parasysh azhurnimin e terrenit e respektimin e masterplanit të kësaj zone dhe të gjithë elementet infrastrukturor. Aktiviteti shoqërohet me rritje të papërfillëshme të qarkullimit gjatë fazës së kryerjes së nderhyrjes. Vetëm projekti ka të bëjë me zhvillimin e rrjetit elektrik TM 20 kV në qytetin e Gjirokastrës, si element i rëndësishëm infrastrukturor që ka të bëjë me plotësimin e nevojave për energji elektrike të konsumatoreve kryesisht nga hoteli Butrinti deri në kanalën e Cukës që ndikon mjaft pozitivisht në zhvillimin e zonës.

f) Përputhshmëria me planin urbanistik rregullues të zonës.

Projekti në fjalë ka të bëjë me zhvillimin e një pjese të rrjetit elektrik TM 20 kV që shërben për furnizimin me energji elektrike që respekton në mënyrë të detyrueshme përputhshmëri të plotë me planin e zhvillimit të kësaj zone. Nderhyrjet sipas projektit nuk i bien ndesh perspektivës së zhvillimit të zonës, por përkundrazi, zgjidhet në mënyrë më të avancuar furnizimi i abonentëve me energji elektrike e cila deri tani ka qenë mjaft problematike.

g) Ndikimi në trashëgiminë kulturore.

Nderhyrjet e parashikuara si rezultat i zbatimit të këtij projekti prekin në disa raste vetëm gjatë fazës së zbatimit të projektit, rruget me kalldrëm si pjesë e rëndësishme e

infrastruktura se qytetit të Gjirokastrës i cili përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, por ndikojnë negativisht në objekte me vlera të veçanta historike e kulturore. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka lidhje direkte me trashëgiminë kulturore në zone që të reflektojnë ndikime të caktuara në këtë aspekt por është një element i rëndësishëm zhvillimi bashkëkohor. Ky projekt jep ndikime të rëndësishme në përmirsimin e pejsazhit duke eliminuar kështu rrjetin ajror të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe mjaft elemente të amortizuara të këtij rrjeti e objekteve të tij.

VIII. MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

a. Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta të krijuara nga punimet për hapjet e trasese, dhera, copera nga asfalti, betonet, pllakat, duhet të evadohen nga operatori për në landfillin e mbetjeve ndertimore e inerte të caktuar nga Bashkia Gjirokastrë. Këto mbetje mund të përdoren edhe si material mbushës në zhvillime të projekteve të tjera që mund të kërkesa.

Gjatë punimeve demontuese në rrjet sipas projekti kemi të bejmë me heqjen e suvave nga muret e kabinave të amortizuara, dherave nga punimet në kabina e hapje kanalesh të cilat duhet të administrohen si mbetje ndertimore dhe të dërgohen në landfillin e miratuara. Ndërsa shtyllat, perçjellesit e zhveshur si dhe sipas rastit traversa e izolatore nuk mund të trajtohen si mbetje për derisa egziston mundësia për të përdorur në një vend tjetër për riparime. Për këto qëllim sigurohet magazinimi i tyre deri në ripërdorim. Izolatorët e demtuar duhet të evadohen për në landfillin e miratuar nga njesia vendore për mbetjet ndertimore.

Të gjitha mbeturinat, bazuar në kategorizimin sipas legjislacionit për mbetjet duhet të administrohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë legjislacion.

Gjatë këtij aktiviteti duhet të zbatohet me rigorozitet:

- Ligji me Nr.10 463, datë 22.9.2011, " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ” i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet menaxhimit të integruar të mbetjeve;

- Per zbutjen e impakteve në tokë shërben sistemimi e organizimi i përshtatshëm i mjedisit të punës. Firma zbatuese duhet të marrë masa e përgjegjësitë për administrimin e përshtatshëm të mbetjeve sipas rastit e natyrës së tyre.

b. Ujrat e përdorura

Gjatë zbatimit të këtij projekti, nuk rezulton të kemi kemi përdorim ose përfitim të veçantë të ujrave me volum potencial e të ndotura që të kenë ndikim negativ në mjedis e që të kërkohen masa për trajtimin e tyre.

c. Ndikimi në ajër.

Aktiviteti i përshkruar me sipër nuk shoqërohet me ndikime potenciale ndotëse në ajër. Pluhurat e shkaktuara gjatë punimeve për trasete ku instalohen kabllo minimizohen nga përdorimi i makinerive prerese që punojnë me lagje, si dhe përdorimi i ujit në formë dushi në mjediset ku punohet. Gjatë zbatimit dhe venies në punë të veprës, nuk kemi të bëjmë me objekte të realizuara si rezultat i projektit që të emetojnë ndotës në ajër.

Subjekti që zbaton projektin i nënshtrohet kërkesave për mbajtjen pastër të mjedisëve qarkulluese e mjedisëve të tjera nëpër objekte, për të mos lejuar rritjen e ngarkesave me pluhur në ajër gjatë veprimeve operacionale të punës. Gjatë zbatimit të projektit duhet të zbatohen:

- Ligji nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” i ndryshuar i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre” i cili përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i

automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye.

d.Zhurmat.

Zhurmat që shkaktohen punimet me makineri e pajiseje, nga automjetet gjatë levizjes për transport të matërialeve janë të përkoheshme, vetem gjatë realizimit të projektit. Duhet berë kujdes për respektimin e nivelit të lejuar të zhurmave pasi disa punime behen edhe pranë objekteve rezidenciale e komplekseve turistike. Kujdes duhet treguar gjithashtu që të mos shkaktohen zhurma në periudhat që mund të shqetësoje frekuentuesit e ketyre objekteve turistike si dhe në oraret e pushimit të banoreve apo në afersit të objekteve publike kur janë të frekuentuara.

Gjatë veprimeve operacionale te nderhyrjeve sipas projektit duhet të respektohen kërkesat e :

- Ligjit me nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;

- Udhëzimit me nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” i cili përcakton nivelet e zhurmave në mjedise të caktuara, të cilat duhet të mbahen parasysht gjatë zbatimit të projektit sidomos per segmenet në afërsi të objekteve turistike që kanë frekuentues.

Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre” i cili përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe i kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsye;

dh. Shfrytezimi i burimeve natyrore

Aktiviteti i parashikuar sipas këtij projekti nuk ka të bëjë me asnjë ndikim direkt në burimet natyrore.

e. Kerkesat teknike, estetike e ekologjike

Masa teknike:

- Per veten natyren e projekti, respektimi i kriterëve teknike të operacioneve gjatë të gjithë veprimtarisë së zbatimit të projekti është i një rëndësie të veçantë .
- Zbatimi i shesheve të distancave të sigurojë prej elementeve të infrastrukturës ku punohet etj, mbrojtja rigoroze gjatë gjithë periudhës së zbatimit e garantimi i sigurisë në objektet sipas projektit për periudhën që funksionon. Rëndësi të veçantë për garantim sigurie marrin punimet në afërsi të objekteve turistike, ose rastet e intersektimit të rrugëve, kanaleve me uje, tumbinove, në anë të Ures së Zingjireve.
- Respektimi i plotë i Regullores së Sigurimit Teknik që lidhet dhe me mënyrën e zgjidhjeve teknike të zbatimit të tyre të të gjitha operacioneve të punës.

Masa estetike e ekologjike

- Rishikimi e kujdesi për vegjetacionin në rastet kur kalon rrjeti ajror që demontohet me qëllim mos demtimin e asnjë druri pyjor ose vegjetacion tjetër, si dhe në rastet e zhvillimit të trasës për kabllot e rinjë nëntokësor.
- Demontimet e segmenteve të vjetra e të amortizuara të linjës elektrike ajrore dhe shpërndarja në vend të tij e energjisë elektrike me kabell nëntokësor ka të bëjë dhe me përmirsim të ndjeshëm të pejsazhit.
- Nderimi i rrjetit elektrik kabllor nëntokësor ndikon dhe në përmirsimin e biodiversitetit sepse shpesh këto linja janë precedent rrezikimi sidomos për shpendet.

ë - Parandalimi i rreziqeve

Për parandalimin e rreziqeve, aktiviteti duhet të mbështetet në Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjen në Punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatimin e tyre të lëshuar nga dikasteret përkatëse.

Subjekti duhet të përcaktojë si detyre ligjore vendosjen e tabelave në vende të dukshme dhe natën të ndriçuara me pjesët kryesore të rregulloreve të sigurimit teknik, sigurimin e kushteve e mjeteve mbrojtëse.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë ndër problemet më kryesore për subjektin gjatë gjithë fazës së zbatimit të projektit dhe garantimit të sigurisë në objektet gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të projektit dhe venies në funksion të rrjetit. Aspektet e sigurisë duhet të respektohen me rigorozitet të lartë konform standarteve teknike ligjore për këtë objekt duke i dhënë rëndësi gjithashtu aspektit të treguesit dhe sinjalizuesit. Për këtë duhet të vendosen tabelat përkatëse në të gjithë zonën e parashikuar në projekt konform standarteve teknike ligjore për këtë qëllim. Një rëndësi të veçantë gjatë zbatimit dhe funksionit të rrjetit merr shënimi dhe markimi i rrjetit nëntoksor kabllor për parandalimin e rreziqeve dhe demtimeve të vetë rrjetit.

Situatat e veçanta që mund të krijohen nga mosnjohja e kushteve teknike të punës, pakujdesitë e ndryshme kërkojnë një vlerësim maksimal të masave mbrojtëse dhe respektimin e rregullores së sigurimit teknik. Në kryerjen e të gjitha operacioneve të punës, duhet të punësohen specialistë me eksperiencë e të kualifikuar në përputhje me kërkesat e profilit të operacioneve të punës. I gjithë aktiviteti në zbatim të projektit duhet të drejtohet nga personeli i kualifikuar i cili do të zbatojë rregullat e përcaktuara në rregulloren e teknikes së sigurimit për çdo rast.

Në këtë rregullore përcaktohen:

Detyrimet e punëdhënesit

Punëdhënësi vetë ose nëpërmjet drejtuesit teknik duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Pajisjet dhe automjetet që përdoren në operacionet e ngarkimit dhe shkarkimit.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për menjanimin e tyre sipas specifikës së aktivitetit.

- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të leshuara nga dikasteret që lidhen me to.
- Veçoritë e punës në, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes për menjanimin e aksidenteve sidomos në kushte të veçanta (reshje, lageshtire etj).
- Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me proceset e punes, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjesve të tjerë, të cilët kryejnë këtë aktivitet ose të tjerë që janë vizitore.
- Ndihamen e parë shendetsore
- Të kryeje instruktim paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e sigurimit teknik për operacione specifike ngarkim shkarkimi.

Detyrimet e punëmarrsit:

- Të njohë mirë përdorim e pajisjeve dhe makinerive për shfrytëzimin e tyre.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundeshme të aksidenteve per çdo proces pune.
- Të siguroje vehtën e punonjesit e tjerë gjatë procesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhë të parë, merr masa për eleminimin e saj, nderkohë lajmëron gjithë punonjesit për rrezikun.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.

Firma zbatuese e punimeve, duhet te mane masa per trainimin e personelit per nderhyrje te shpejta ne rast avarish gjate procesit te punes sipas kerkesave te MNZ-se. Firma ndertuese duhet te zbatoje me rigorozitet kërkesat e MNZ-se për te perfshirë brenda ketij projekti vendosjen e fiksave brenda ambjenteve te punes.

IX. MONITORIMI I MJEDISIT.

Gjate zbatimit të projektit dhe funksionit të objektit të zhvilluar nuk ka përcaktime ligjore për monitorime të treguesve të caktuar dhe raportimin e tyre.

Gjate zhvillimit të projektit operatori duhet të respektojë një sërë kërkesash që rrjedhin nga detyrimet ligjore mjedisore të cilesuara me sipër, dhe duhet t'i evidentojë sipas kërkesave të organeve kompetente dhe në veçanti ato të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit. Për çdo rast të ndryshimeve potenciale në mjedis, të paparashikuara, si rezultat i aktivitetit, administratori i zbatimit të projektit dhe perfituesit nga rezultatet e projektit, duhet të marrë masa mbrojtëse dhe të njoftojë menjëherë DRM-në Gjirokaster, me qëllim mbajtjen nën kontroll të situatës në përputhje me standartet mjedisore.

X. KONKLUZIONE.

Në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është parashikuar zbatimi i projektit duke pasur parasysh të gjitha kushtet për mbrojtjen e mjedisit, bazuar në:

- Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili përcakton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejes mjedisore;
- Ligjin nr. 10440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces dhe mënyrën e miratimit të lejes mjedisore;

Po kështu ky raport bazohet në të gjithë kuadrin ligjor mjedisor për vëndin tonë.

Ky raport kontrollohet nga organet shtetërore kompetente.

- Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shoqërohet me ndikime potenciale në mjedis por jep një kontribut mjaft të dukshëm në përmirësimin e pejsazhit dhe të mjedisit në përgjithësi.
- Masat për mbrojtjen e mjedisit të parashtruara në këtë raport janë të plota për minimizimin e ndikimeve në mjedis.
- Aktiviteti kontribuon në plotësimin e nevojave për përdorim eficient të energjisë elektrike në harmoni të plotë me mbrojtjen e mjedisit.

Ky raport u përgatit nga:

KULD shpk me nr. Nipti

K88304501J

License e QKL-se nr. LN-7295-01-

2014

EKSPERT MJEDISI

Jak GJINI

Çertifikuar sipas Vendimit Nr.
10, datë 24.07.2008 të me nr. 531
Prot. nga Ministria e Mjedisit.